




UNIVERSITETI
BARLETI



QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE
"NËNË TEREZA"

UNIVERSITETI BARLETI

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE
NËNË TEREZA

Universiteti Barleti

Nr. prot. 1878/2.. Datë: 03.12.21

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Nr.

prot. 3084/1, datë 03.12.2021

Marrëveshje Bashkëpunimi

Ndërmjet:

Universitetit Barleti

dhe

Qendra Spitalore Universitare

"Nënë Tereza",

Tiranë

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit midis institucioneve firmëtare, duke përcaktuar detyrimet e përgjithshme të palëve, drejt realizimit në një moment të dytë të marrëveshjeve specifike lidhur me fushat e bashkëpunimit e shkëmbimit të listuara në pikën 2 të këtij neni. Në marrëveshjet specifike do të detajohet lloji i aktiviteteve të përbashkëta, si dhe çdo detyrim financiar midis palëve.

2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke midis palëve në fushat si vijon:

- a. Shkëmbim të stafit akademik/mjekësor dhe personelit teknik;
- b. Praktika mësimore në kuadër të procesit akademik dhe specializimeve;
- c. Aplikim të përbashkët në projekte dhe programe të ndryshme bashkëpunimi;
- d. Organizim të seminareve, konferencave, publikimeve dhe aktivitete të ndryshme
- e. shkencore;
- f. Përdorim të ambienteve respektivisht për praktika, laboratore, seminare, konferenca etj;
- g. Promovim të palëve në kuadër të aktiviteteve të secilit partner.
- h. Punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.

Neni 2

Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy institucionet janë dakord për këtë. Nëse njëri prej institucioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 3 (tre) muaj përpara.

2. Mos rinovimi i kësaj marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga institucioni i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Neni 3

Informacion mbi palët

1. *Universiteti BARLETI* ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkuruar në tregun kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Misioni i Univeristetit është krijimi i një institucioni akademik elitare, bazuar në praktikën e vlerat më të mira kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, me programe shumëdisiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.

2. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (në vijim QSUT) është institucioni shëndetësor më i madh në Shqipëri dhe si institucion shëndetësor akademik është i vetmi i këtij lloji, duke u klasifikuar si e vetmja qendër shëndetësore terciare shqiptare.

Aktualisht QSUT ofron shërbim shëndetësor ambulator për rreth 300 000 persona/vit, shërbim spitalor për mbi 80 000 raste/vit dhe shërbim urgjencash me mbi 260 000 persona/vit. Spitali ka një kapacitet prej 1450 shtretërish dhe ofron ndihmë mjekësore për mesatarisht 400 pacientë ditorë e të shtruar.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. Universiteti Barleti:

- a. Barleti angazhohet në ofrimin e ambjeteve për trajnime, ëorkshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- b. Barleti angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje.
- c. Barleti angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut QSUT, sipas kërkesës së QSUT, duke vënë në dispozicion specialistët e tij më të mirë;
- d. Barleti shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave të Universitetit për ngritjen dhe konsolidimin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standartet më të mira në nivel evropian;

2. Qendra Spitalore universitare "Nënë Tereza":

- a. QSUT angazhohet në ofrimin e ambjenteve spitalore të nevojshme për realizimin e laboratorëve, praktikave dhe specializimin e studentëve të Barletit;
- b. QSUT angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, ëorkshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- c. QSUT angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
- d. QSUT angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut Barletit, sipas kërkesës së Barletit, duke vënë në dispozicion stafin e nevojshëm mjekësor dhe ndihmës;

3. Palët bashkarisht bien dakort si vijon:

- a. të organizojnë takime periodike, të paktën 1 (një) herë në vit.

Neni 5


Dispozita të fundit

3. Kjo marrëveshje përmban 4 (katër) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën vlerë ndër të cilat 2 (dy) i mban Marin Barleti dhe 2 (dy) QSUT. Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

UNIVERSITETI BARLETI

REKTOR

PROF. DR. SUZANA GUXHOLLI



QENDRA SPITALORE "NËNË TEREZA"

DREJTOR

